

LUSHNJË

Nr. 108 (858) Regj.Them
Datë rregj. 09.10.2019

Nr. 109 (2195) Vendimi
Datë 24.10.2019

VENDIM NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e përbërë nga:

GJYQTARE: LORENA ÇABEJ

asistuar nga sekretare gjyqësore Nertila Shaska, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, sot më datë 24.10.2019 shpall këtë vendim lidhur me çështjen penale nr. 108 (858) që i përket:

KËRKUES: {xxx}, i biri i {xxx} dhe xxx, lindur në Lushnjë dhe banues në Durrës, i datëlindjes {xxx}, përfaqësuar nga Av. {xxx}, me Nr. {xxx} License dhe NUISL {xxx}, Dhoma e Avokatisë Gjirokastër.

PERSON I TRETË: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, përfaqësuar nga prokuror Skënder Mestani.

OBJEKTI: Kërkohet kthimi i shumës 7,060 Euro së sekuestruar më datë 01.10.2019 të cilat janë në pronësi të kërkuesit {xxx}.
Kthimi i mjetit me targa {xxx}, i markës "Porsche Cayenn".

BAZA LIGJORE: Neni 212, 301 i Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA:

Në përfundim të seancës gjyqësore, të zhvilluar në prani të përfaqësueses ligjore të kërkuesit dhe në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë, pasi shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilët kërkuan:

- **Kërkuesi:** Pranimin e kërkesës dhe kthimin e sendeve të sekuestruara sipas objektit të kërkesës. Mbrojtësja e kërkuesit pretendoi se shuma e parave të sekuestruara nuk kanë lidhje me ndonjë veprimtari kriminale por janë mbledhur nga të afërmit e kërkuesit për shkak se atij i duhen për një ndërhyrje të specializuar mjekësore në Turqi. Automjeti i sekuestruar nuk është në pronësi dhe as në posedim të kërkuesit {xxx} por është në pronësi të shtetasit {xxx}.

- **Prokuroria:** Kërkoj nga Gjykata rrëzimin e kërkesës, pasi sekuestrimi i sendeve i shërbente një procedimi penal të nisur pranë Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në të cilën shtetasi {xxx} është në cilësinë e personit nën hetim për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

VËREN

Se kërkuesi {xxx} i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me kërkesën sipas objektit të sipërcituar.

Nga ana procedurale, kërkesa i’u njoftua prokurorisë. Seanca gjyqësore u zhvillua në prani të përfaqësueses ligjore të kërkuesit dhe në prani të përfaqësuesit të organit të akuzës. Nga ana e palëve në proces nuk pati pretendime lidhur me kompetencën apo juridiksionin e Gjykatës, ndarjen apo bashkimin e procedimeve. Gjykata çmon se bazuar në nenet 69, 74, 76 e 301 të K.Pr.Penale ka juridiksion dhe kompetencë lëndore e tokësore për gjykimin e kësaj çështje. Gjykata konstatoi kryesisht se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie për gjykimin e kësaj çështjeje. Gjykimi i kësaj kërkesë penale u zhvillua nga një trup gjykues i formuar nga gjyqtar i vetëm.

Në kërkesën objekt gjykimi, kërkuesi pretendon kthimin e sendeve të sekuestruara me vendimin datë 03.10.2019 “Për vleftësimin e sekuestror”. Nga aktet e ndodhura në dosje si edhe nga shpjegimet e palëve në seancë gjyqësore, rezulton se me Porcesverbalin datë 01.10.2019 ora 17:00 nga oficeri i Policisë Gjyqësore {xxx}, është vendosur sekuestrimi i sendeve të gjetura gjatë kontrollit të kryer në banesën e shtetasit {xxx}. Sipas procesverbalit rezulton se sendet e gjetura vlerësohen si prova materiale ose sende të lidhura me një vepër penale dhe janë:

1. 592 kartëmonedha të prerjes 50 Euro, gjithsej 29,000 Euro.
2. 1910 kartëmonedha të prerjes 20 Euro, gjithsej 38,000 Euro.
3. 226 kartëmonedha të prerjes 10 Euro, gjithsej 2260 Euro.
Gjithsej 70,060 Euro.
4. Një automjet tip Porsche Cayenn me targa {xxx}, në pronësi të shtetasit {xxx}. Automjeti i mësipërm ndodhet në Komisarriatin e Policisë Lushnjë dhe është shoqëruar nga punonjësit e Policisë Lushnjë.

Brenda 48 orësh, me Vendimin datë 03.10.2019 ora 12:00 është marrë nga prokurori Skënder Mestani Vendimi “Për vleftësimin e sekuestror.”, në përputhje me nenin 301/2 të K.Pr.Penale që parashikon: “*Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet.*”

Ky vendim i është njoftuar kërkuesit {xxx} brenda afatit 72 orë që parashikon neni 301 i K.Pr.Penale. Kundër këtij vendimi, kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në përputhje me parashikimet e nenit 301 të K.Pr.Penale: “*Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë*

sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestro.”

Në kërkesën objekt gjykimi, kërkuesi pretendoi se shuma e sekuestruar është mbledhur prej tij me ndihmën e familjarëve për kryerjen e një operacioni në Turqi që kushton 100,000 (njëqind mijë) Euro. Ai pretendoi se kjo shumë nuk ka lidhje me ndonjë veprimtari kriminale. Automjeti i sekuestruar në oborrin e banesës së shtetasit {xxx} nuk është në pronësi të tij dhe as përdoret prej tij. Ai është në pronësi të shtetasit {xxx} dhe gjendej në oborrin e banesës që të mos lihej nëpër rrugicat e qytetit.

Kërkuesi pretendoi se vendimi i prokurorit për sekuestron ishte i paligjshëm për dy arsye. Së pari, sepse nuk është shpjeguar nga prokuroria nëse sendet janë sekuestruar në kuadër të ndonjë procedimi penal dhe për çfarë vepre dyshohet {xxx}. Së dyti, u pretendua se vendimi nuk është i arsyetuar se përse këto sende duhet të sekuestrohen apo të ketë indicie për ndonjë veprimtari kriminale. Për këto arsye, kërkuesi kërkoi nga Gjykata pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

Prokuroria deklaroi para Gjykatës se sekuestrimi i sendeve sipas Vendimit datë 03.10.2019 është bërë në kuadër të një procedimi penal të nisur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në kuadër të këtij procedimi, shtetasi {xxx} ka statusin e personit nën hetim për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Prokuroria argumentoi se nëse pas përfundimit të hetimit nuk do të ketë prova në mbështetje të akuzës, atëherë sendet do t'i kthehen personave që i përkasin. Prokuroria parashitroi se në këtë moment procedural sekuestrimi i shërben procedimit penal dhe kërkoi nga Gjykata rrëzimin e kërkesës.

Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi {xxx} nuk është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

Nga organi i akuzës u parashtrua në proces, se ndaj shtetasit {xxx} ka nisur një procedim penal në të cilin ai aktualisht ka statusin e personit nën hetim për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Sipas Kodit të Procedurës Penale një nga mjetet për kërkimin e provës është kontrolli dhe sekuestrimi. Në kushtet kur ndaj personit nën hetim (për llogari të procedimit tjetër penal për të cilin nuk disponohen më tepër të dhëna për shkak të sekretit hetimor) është kryer kontroll në banesë dhe janë gjetur sende të cilat janë vlerësuar se mund të kenë lidhje me veprimtarinë kriminale të lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, është çmuar sekuestrimi i tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Ky vendim është vleftësuar si i ligjshëm nga prokurori brenda afatit 48 orë me Vendimin datë 03.10.2019. Në këto kushte, Gjykata çmon se janë respektuar plotësisht dispozitat procedurale në lidhje me sekuestron parashikuar nga neni 301 i K.Pr.Penale. Vendimi i është njoftuar brenda 72 orëve kërkuesit për t'i dhënë mundësi ankimi. Në këtë fazë të hetimit, Gjykata çmon vetëm respektimin e procedurës në lidhje me sekuestron dhe nuk mund t'i hyjë meritës në lidhje me veprimet e organit të akuzës, jo vetëm sepse çështja penale është ende në hetim por edhe sepse ky trup gjykues nuk është gjyqtar i hetimeve paraprake dhe nuk disponon të dhëna të detajuara në lidhje me hetimin.

Për sa kohë që procedimi penal në ngarkim të shtetasit {xxx} është ende në vazhdim është organi i akuzës ai që i njeh dhe i vlerëson nevojat e hetimit si dhe përcakton veprimet hetimore të nevojshme për t'u kryer në kuadër të tij. Ashtu siç parashtroi edhe akuza, nëse në përfundim të hetimit nuk dalin të dhëna dhe prova bindëse në mbështetje të akuzës, sendet e sekuestruara me Vendimin datë 03.10.2019 do t'i kthehen pronarëve të ligjshëm në përputhje me parashikimet e K.Pr.Penale.

Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit {xxx} me objekt kthimin e sendeve të sekuestruara është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

Për këto arsye

Për këto arsye, Gjykata krijoi bindjen dhe bazuar në nenin 301 dhe 379 të K.Pr.Penale,

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës me Nr. 108 (858) rregj.themeltar të paraqitur nga kërkuesi {xxx} me objekt kthimin e sendit të sekuestruar.
2. Shpenzimet procedurale siç janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi lejohen ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. U shpall në Lushnjë më 24.10.2019.

SEKRETARE

Nertila Shaska

GJYQTARE

LORENA ÇABEJ